

QENDRA FAKTOJE

Pasqyrat Financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(dhe raporti i Audituesit të Pavarur bashkëlidhur)

PËRMBAJTJA:

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA E AKTIVITETEVE.....	2
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE.....	3
SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE.....	4-8



RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar : Antareve te Bordit te Qendra “ Fakte ”

Adresa : Rruga Nasi Pavllo , Pallati Edil - Al , SHK.1 , Kati 3 , AP. 8 , Tirane

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Qendra “ Fakte ” Tirane të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2024, pasqyrën e e aktiviteteve dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale,, pozicionin financiar të organizates Qendra “ Fakte ” me datën 31 Dhjetor 2024, si dhe performancën financiare dhe flukseve e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet e Kontabilitetit per Organizatat Jo- Fitimprurese të Permiresuara ne Shqiperi . (SKK per OJF)

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-te). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare . Ne jemi të pavarur nga Qendra “ Fakte ” në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare ne Shqiperi dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa . Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë opinionin tonë te auditimit.

Ceshtjet kryesore te Auditimit

Ceshtjet kryesore te auditimit jane ato ceshtje , qe nen gjykimin tone profesional ishin me te rendesishmet gjate auditimit te pasqyrave financiare te periudhes aktuale. Keto ceshtje jane adresuar ne kontekstin e auditimit te pasqyrave financiare ne teresi dhe gjate formimit te opinionit tone , per rjedhoje dhe ne nuk paraqesim nje opinion te vecante per keto ceshtje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit per Organizatat Jo - Fitimprurese të permiresuara ne Shqiperi, (SKK per OJF) dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Qendres “ Fakte ” për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Qendren “ Fakte ” ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Qendres “Fakte ”.

EURO - AUDIT
CONSULTANCY.CO Sh.p.k.
TIRANE - ALBANIA



Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Entitetit, për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Entiteti të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Date 26/03/2025

Shoqëria audituese
“Euro – audit, consultancy. Co” shpk
Audituesi ligjor
Paqesor Qato




QENDRA FAKTOJE
Pasqyra e Pozicionit Financiar


(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
<u>AKTIVET</u>			
<i>Aktive afatshkurtra</i>			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	4	31,456,687	28,111,241
Investime afatshkurtra dhe të tjera të arkëtueshme	5	999,360	20,364,773
Totali i aktiveve afatshkurtra		32,456,047	48,476,014
<i>Aktivet afatgjata</i>			
Investime afatgjata	6	43,116,086	20,000,000
Aktivet e qëndrueshme, neto	7	2,450,201	2,275,058
Aktive afatgjata ne proces	8	41,469,129	-
Totali i aktiveve afatgjata		87,035,416	22,275,058
TOTALI I AKTIVEVE		119,491,463	70,751,072
<u>DETYRIMET</u>			
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>			
Llogari të pagueshme	9	3,842,684	1,056,019
Grante të periudhave të ardhshme	10	1,936,490	2,671,018
Totali i detyrimeve afatshkurtra		5,779,174	3,727,037
TOTALI I DETYRIMEVE		5,779,174	3,727,037
Aktivet Neto	11	113,712,289	67,024,035
TOTALI I DETYRIMEVE DHE AKTIVIT NETO		119,491,463	70,751,072

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse në faqet 4 deri në 8, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të "Qendra Faktoje" janë përpiluar më 26.03.2025 dhe nënshkruar nga:



Klodiana KAPO
Drejtues ekzekutiv


PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k
Hartues



QENDRA FAKTOJE
Pasqyra e Aktiviteteve

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
<u>TË ARDHURAT</u>			
Të ardhura nga grante	12	92,482,289	76,260,054
Totali i të Ardhurave		92,482,289	76,260,054
<u>SHPENZIMET</u>			
Shpenzime për paga dhe sigurime	13	(25,055,522)	(24,280,101)
Shpenzime organizimi	14	(1,627,567)	(1,337,694)
Shpenzime promovimi dhe publikime	15	(11,776,367)	(8,150,638)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrimi	16	(5,533,109)	(5,170,681)
Shpenzime amortizimi	7	(640,545)	(386,001)
Të ardhura/(shpenzime) financiare neto	17	(1,160,925)	(1,480,817)
Totali i Shpenzimeve		(45,794,035)	(40,805,932)
Ndryshimi në aktivet neto		46,688,254	35,454,122
Aktivët Neto në fillim të vitit	11	67,024,035	31,569,913
Aktivët Neto në fund të vitit		113,712,289	67,024,035

Pasqyra e Aktiviteteve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse në faqet 4 deri në 8 pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

QENDRA FAKTOJE
Pasqyra e Fluksit të mjeteve monetare
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Teprica/(Deficiti) i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve	46,688,254	35,454,122
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizim dhe zhvlerësim	7 640,545	386,001
Pakësime për nxjerrje jashtë përdorimit AAM	7 -	74,197
Interesa të llogaritur	5 54,019	(247,618)
Te ardhura nga rivlerësimi i investimit kuota	(416,084)	-
	46,966,734	35,666,702
<i>Ndryshime në kapitalin qarkullues:</i>		
(Rritja)/pakesim Llogari të arkëtueshme	5 (742,607)	(5,369)
Rritja/(pakesim) ne Grante te periudhave te ardhshme	10 (734,527)	2,564,109
Rritje/(pakesim) Pagesa për llogaritë e pagueshme	9 2,786,663	242,863
Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit	48,276,263	38,468,305
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		
(Blerje) / Shitje e aktiveve afatgjata	7/8 (42,284,817)	(1,532,877)
Investim afatgjate	6 (22,700,000)	(20,000,000)
(Investime)/Mbyllje depozitë me afat	5 20,054,000	(20,054,000)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese	(44,930,817)	(41,586,877)
RRITJE/(RËNIE) NETO E MJETEVE MONETARE	3,345,446	(3,118,572)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës	4 28,111,241	31,229,813
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës	4 31,456,687	28,111,241

Pasqyra e Flukseve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse ne faqet 4 deri në 8, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

QENDRA FAKTOJE

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

1. Informacion i Përgjithshëm

Qendra Faktoje (në vijim "Faktoje" ose "Qendra") është një organizatë jo-fitimprurëse themeluar më 11 Shtator 2019 me seli në adresën: Rr: "Nasi Pavlo", Pallati Edil-AL, Shk.1 Kati 3, Ap.8

Faktoje është një qendër mediatike që merret me verifikimin e fakteve duke vlerësuar deklaratat e zyrtarëve publikë dhe politikanëve, si dhe duke analizuar çështje me interes dhe ndikim madhor publik që përfshijnë tematikat kyce në jetën e shoqërisë.

Faktoje, si anëtare nënshkruese e IFCN-së (Rrjeti Ndërkombëtar i Verifikuesve të Fakteve) dhe bashkëthemeluese e - Rrjetit të Anti-Dizinformimit për Ballkanin (AD), verifikon artikujt sa u përket fakteve duke u bazuar në burime të besueshme që mund të gjenden edhe jashtë Shqipërisë. Qëllimi përfundimtar i Faktoje është përmirësimi i standardeve të performancës publike në Shqipëri.

2. Baza e Përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) për OJF-të dhe ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. SKK për OJF-të ka hyrë në zbatim nga data 1 janar 2016.

Pasqyrat Financiare paraqiten në Lekë (Lekë), e cila është dhe monedha funksionale e Qendrës.

(a) Kosto Historike

Elementët në pasqyrat financiare janë njohur me koston historike.

(b) Parimi i vijmësisë

Pasqyrat financiare përgatiten sipas parimit të vijmësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e Qendrës do të ketë vijmësi, dhe se nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj.

Faktoje vlerëson se do të vijojë aktivitetin bazuar mbi parimin e vijmësisë, për një periudhë kohe të paktën për 12 muajt e ardhshëm.

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që do të arkëtohet. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë me të ardhurat që lidhen me to.

Të ardhurat kryesore të Faktoje krijohen nga kontributet e donatorëve bazuar tek projektet specifike të cilat ndërmerr Qendra.

Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e asaj date, të shpallur nga Banka e Shqipërisë.

Diferencat nga kursi i këmbimit, njihen në fitim ose humbje të periudhës të cilës i përkasin.

Kursi i këmbimit më:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
LEKË/EUR	98.15	103.88
LEKË/USD	94.26	93.94
LEKË/GBP	118.16	119.47

QENDRA FAKTOJE

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël (vazhdim)

Aktivët Afatgjatë Materiale (AAM)

Vlerësimi fillestar i elementeve që plotësojnë kriteret për njohjen si AAM në bilanc është bërë me kosto blerje plus kosto të tjera të drejtpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të Qendrës. Vlerësimi i mëpasshëm është bërë sipas modelit të koston dhe AAM-të janë paraqitur në bilanc sipas vlerës së tyre neto (minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin, nëse ka).

Normat e amortizimit dhe metoda sipas grupeve të AAM:

	Norma e Amortizimit	Metoda e përdorur
Pajisje informatike	25%	Lineare
Pajisje dhe mobilje zyre	20%	Lineare
Mjete Transporti	20%	Lineare

Tatimet dhe taksat

Faktoje është organizatë jofitimprurëse dhe është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin. Faktoje është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale, taksave dhe tarifave vendore dhe kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetsore.

4. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari rrjedhëse në USD	23,542,985	732,796
Llogari rrjedhëse në Lekë	5,438,855	5,777,407
Llogari rrjedhëse në Euro	2,414,222	21,571,242
Para në arkë	60,625	29,796
Totali	31,456,687	28,111,241

5. Investime afatshkurtra dhe të tjera të arkëtueshme

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Parapagime të dhëna	593,936	-
Interes i llogaritur	193,599	247,618
Shpenzime për t'u shpërndarë	162,750	63,155
Të drejta të arkëtueshme	49,075	-
Depozitë me afat	-	20,054,000
Totali	999,360	20,364,773

6. Investime afatgjatë

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Investim afatgjatë në fond	23,116,086	-
Letra me vlerë qeveritare	20,000,000	20,000,000
Totali	43,116,086	20,000,000

QENDRA FAKTOJE**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare***(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***7. Aktivet e qëndrueshme**

Aktivet e qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

	Mjete transporti	Pajisje informatike	Pajisje dhe mobilje zyre	Të tjera	TOTALI
Kosto					
Në 31 Dhjetor 2022	247,058	813,459	363,411	162,420	1,586,348
Shtesat gjatë vitit 2023	-	1,366,452	166,425	-	1,532,877
Pakësimi gjatë vitit 2023	-	(44,370)	-	(40,920)	(85,290)
Riklasifikime gjatë vitit 2023	-	121,500	-	(121,500)	-
Në 31 Dhjetor 2023	247,058	2,257,041	529,836	-	3,033,935
Shtesat gjatë vitit 2024	-	815,688	-	-	815,688
Pakësimi gjatë vitit 2024	-	-	-	-	-
Në 31 Dhjetor 2024	247,058	3,072,729	529,836	-	3,849,623
Amortizimi i Akumuluar					
Në 31 Dhjetor 2022	88,941	182,876	112,151	-	383,968
Amortizimi gjatë vitit 2023	31,623	290,742	63,636	-	386,001
Pakësimi gjatë vitit 2023	-	(11,092)	-	-	(11,092)
Në 31 Dhjetor 2023	120,564	462,526	175,787	-	758,877
Amortizimi gjatë vitit 2024	25,299	561,662	53,584	-	640,545
Pakësimi gjatë vitit 2024	-	-	-	-	-
Në 31 Dhjetor 2024	145,863	1,024,188	229,371	-	1,399,422
Vlera Neto					
Në 31 Dhjetor 2022	158,117	630,582	251,261	162,420	1,202,380
Në 31 Dhjetor 2023	126,494	1,794,515	354,049	-	2,275,058
Në 31 Dhjetor 2024	101,195	2,048,541	300,465	-	2,450,201

8. Aktive afatgjata në proces

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Zyra	40,251,028	-
Punime ne proces	1,218,101	-
Totali	41,469,129	-

Qendra gjatë vitit 2024 ka kryer blerjen e 2 apartamenteve të cilat janë në proces rinovimi dhe do të shërbejnë si zyra të saj.

9. Llogari të pagueshme

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Furnitorë	2,136,571	210,093
Tatimi mbi të ardhurat personale	654,386	415,213
Parapagime të marra	576,836	-
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	368,676	387,355
Tatim në burim	93,857	43,358
Shpenzime të llogaritura	12,358	-
Totali	3,842,684	1,056,019

QENDRA FAKTOJE**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare***(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***10. Grante të periudhave të ardhshme**

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Grante të periudhave të ardhshme	1,936,490	2,671,018
Totali	1,936,490	2,671,018

11. Aktivet Neto

Aktivi neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të Faktoje në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Ndryshimi në aktivet neto paraqitur në pasqyrën e aktiviteteve artikullohet në aktivet neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar. Aktivet neto të paraqitura si të pakufizuara, përdoren në periudhat në vijim vetëm për objektivat e përcaktuara në statutin e Faktoje.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Balanca e mbartur në fillim të periudhës	67,024,035	31,569,913
Rritje/(Ulje) në aktivet neto	46,688,254	35,454,122
Balanca e mbartur në vitin e ardhshëm	113,712,289	67,024,035

12. Të ardhurat

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të ardhura nga grante	92,482,289	76,260,054
Totali	92,482,289	76,260,054

13. Shpenzime per paga dhe sigurime

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Paga personeli	22,293,964	21,585,399
Kontribute për sigurim të detyrueshëm	2,761,558	2,694,702
Totali	25,055,522	24,280,101

14. Shpenzime organizimi

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzime për platformën	876,483	431,607
Shpenzime për transport	623,944	906,087
Shpenzime per evente dhe takime	127,140	-
Totali	1,627,567	1,337,694

15. Shpenzime promovimi dhe publikime

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Personel jashtë ndërmarrjes	6,327,370	4,501,776
Publikime	5,448,997	3,176,933
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	-	471,929
Totali	11,776,367	8,150,638

QENDRA FAKTOJE**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare***(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***16. Shpenzime të përgjithshme dhe të administrimit**

Shpenzimet e përgjithshme dhe të administrimit për vitin 2024 janë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzime konsulence	1,110,540	960,067
Kontribute për sigurim vullnetar	920,000	822,000
Kancelari & të tjera të konsumueshme	788,187	453,767
Qira	776,472	711,766
Shpenzime të tjera	644,238	929,536
Shpenzime komunikimi	561,302	215,685
Komisione bankare	272,434	147,419
Shpenzime për mirëmbajtje	229,180	513,026
Shpenzime utilitare	142,132	127,145
Shpenzime sigurim stafi	71,624	259,030
Taksa lokale e të tjera	17,000	31,240
Totali	5,533,109	5,170,681

17. Te ardhura/(shpenzime) financiare neto

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzime të tjera të përgjithshme	-	(7,274)
Shpenzime për interesa	(2,175)	(9)
Humbje nga kembimet valutore	(3,554,325)	(2,094,322)
Te ardhura nga interesat investimi	829,658	620,788
Fitim nga kembimet valutore	1,149,833	-
Rivlerësimi i investimit në kuota	416,084	-
Totali	(1,160,925)	(1,480,817)

18. Ngjarjet pas datës së raportimit

Drejtimi i Qendrës nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime apo shpjegime shtesë në këto pasqyra financiare.